

JETA MUZIKORE E QYTETIT SHQIPTAR NË SHEKUJT XVI-XVII

Në muzikën urbane¹ të viseve të Rajonit ndikimet e muzikës së ardhur prej Lindjes janë shfaqur vetëm në periudhën e vonë të Antikitetit, por vazhdimësia e tyre ka qenë e pandërprerë deri në periudhën paraosmane. Ajo që mund të gjykojmë mbi sasinë dhe cilësinë e këtyre ndikimeve, është vetëm që në periudhën e pushtimit osman këto ndikime u bënë më intensive², u shtrinë në një hapësirë më të gjerë³ dhe u shfaqën në pamje të larmishme⁴, deri sa në ndonjë rast, në qytete apo në zona të caktuara, u bënë forma e vetme alternative e shprehjes muzikore urbane dhe u shfaqën nën trajtën e huazimit.⁵

1. Drejt shekullit XVII Burimet ikonografike

Burimet ikonografike dëshmojnë se sidomos duke filluar me shekullin XIII ndikimi kulturave lindore në Rajon bëhet i dukshëm. Kështu, në se shqyrtojmë tabelat që përshkruajnë instrumentet muzikore të pasqyruara në afresket e kishave të Rajonit dhe në shkrime të tjera të Kishës të botuara në librin e Roksanda Pejovic *Muzicki instrumenti srednevekovne Srbije* (PEJOVIC, 2005-295 deri 312), do të vërejmë se krahas instrumenteve të trashëguara nga bota greko-romake dhe bizantine, në këto afreske dhe dokumente shfaqen edhe instrumente të ardhura nga Lindja. Disa prej tyre janë shumë të shpeshtë, si: tabl-i (bubanj/tupan) curla, zurnaja (shalmei) etj., ndërsa disa të tjerë më të rrallë (darabuka, rebec, kemenceh etj.). Ndonëse, fatkeqësisht, këto tabela nuk janë të plota,⁶ përsëri ato mund të na tregojnë në linja të trasha prirjen e zhvillimit të kësaj dukurie.

Nëse shqyrtojmë vetëm ato instrumente që kanë prejardhje të padyshimtë lindore, vërejmë se, p.sh., tabl-i (*bubanj/tupan* etj.) në Greqi ⁷ shfaqet për herë të parë në shekullin XI; në Serbi, Shqipëri dhe në Bullgari shfaqet në shek. XIII dhe në Rumani në shek. XIV. Shalmaj (*curle, zurna* etj.), në Greqi shfaqet qysh në shekullin VII (vitet 610-629) ⁸; në Serbi në shek. XIII; në Rumani shek. XIV dhe në Bullgari vetëm në shek. XVII. Në Shqipëri shalmaj shfaqet në shek. XVI.

Ndërkaq, në Serbi vërejmë të shfaqen edhe instrumente, si: darabuka, (shek. XIII); rebec, kemenceh (shek. XV) dhe gusle (shek. XVI); në Greqi në shek. XIV shfaqet edhe lahuta me qafë të përkulur (*udi?*) etj. ⁹

Në një pamje të parë, përfundimet që mund të nxjerrim prej këtyre të dhënave, janë dy. *Së pari*, që këto instrumente shfaqen në Rajon duke filluar përgjithësisht me shek. XIII ¹⁰ dhe, *së dyti*, që shpeshësia e shfaqjes së tyre vjen duke u rritur, sidomos duke filluar me shek. XVI.

Këtu duhet të shtojmë se instrumente përdorshin në jetën e përditshme, laike. Kisha ortodokse nuk përdorte instrumente në liturgjitë e saj. Një analizë e hollësishme e dokumentacionit që përmendëm më lart (pamja e muzikantëve, veshja e tyre, ambienti etj.), mund të na sjellë shumë të dhëna të tjera mbi prejardhjen, mbi shtresat shoqërore që luanin në këto instrumente (ciganë?) dhe mbi vendin që ato zinin në jetën e përditshme. Por nuk është ky qëllimi i kësaj trajtëse.

Ndërkaq, rruga nëpër të cilën ato kanë ardhur në Rajon duket se është edhe e drejtpërdrejtë ¹¹, por edhe nëpërmjet Bizantit, sepse daullja (*Taoulin*) dhe zurnaja (*Zorne*) ishin instrumente popullore greko-bizantine qysh me shpërnguljet e para të ciganëve nga India për në viset e Bizantit. Një shekull më pas, Evlija Çelebiu na informon se në Konstantinopojë kishte „1100 *Esnafe muzikantësh*“ (ÇELEBI, 1896, Vol. I-545). Sado i paktë të ketë qenë ky numër në periudhën për të cilën bëjmë fjalë, përsëri nuk mund të jetë i papërfillshëm.

Burimet gjuhësore

Afërsisht në të njëjtën periudhë, shfaqen në Rajon edhe huazimet e para nga gjuhët perso-arabo-turke, në fillim të pakta e të

kufizuara dhe, më pas, me një intensitet gjithnjë e në rritje ¹². Kryesisht ato prekën fjalorin (sollën fjalë të reja, vendosën një sërë prapashtesash etj) por nuk patën ndonjë ndikim në sistemin fonetik dhe në strukturën e gjuhëve ballkanike. (DEMIRAJ, 1994-195 dhe 196)

Në Shqipëri, fjala e parë e huazuar nga bota perso-arabo-turke është fjala „haraç„ (1451). Ajo „del që herët në një marrëveshje të Skënderbeut me Alfonsin e Aragonës, mbret i Napolit e i Sicilisë“ (ÇABEJ, 1975-85). Megjithatë, sipas dokumenteve të shkruara, ritmi i këtyre huazimeve në shekujt XV-XVI është i ngadaltë ¹³ ndonëse prek „sfera të ndryshme të kulturës materiale dhe shpirtërore“ (DEMIRAJ, 1994-196). Ndër këto „sfera“ përfshihet edhe muzika.

Duket se fjalët e para të huazuara nga fusha e muzikës kanë qenë emra instrumentesh. Çabej i gjen fjalët „bori“ dhe „daulle“ qysh te shtresat më të vjetra të huazimeve, te kolonitë italo-shqiptare në Kalabri e Sicili (ÇABEJ, 1976, fq. 67), por „edhe atje, edhe këtu (në Shqipëri - shën. ynë)“ (po aty, 68) dhe pranon se kjo shtresë leksiku në atë kohë duhet të ketë qenë më e madhe ¹⁴.

„Më e madhe“ ndërkaq nënkupton edhe se këto huazime janë më të lashta se sa koha për të cilën bëhet fjalë (mesi shek. XV). Dhe në këtë pikë argumenti gjuhësor përputhet me dëshmitë ikonografike të cilat e shtyjnë përdorimin e këtyre instrumenteve në Rajon deri në shekujt XIII-XIV.

Një burim historik

Fatkeqësisht, nga kjo periudhë ne njohim (deri tani) vetëm një dokument që mund të na sqarojë ndonjë gjë. Ky është Defteri i hollësishëm i Livasë së Vlorës i vitit 1583. Në të mësojmë se, me që kanë marrë pjesë në luftimet kundër „flotës së të pafeve“ (DUKA, 2001-239) dhe në mbrojtjen e „nahijes së Kurveleshit“, falen prej taksës së avrazit të Divanit dhe nga taksat e zakonshme (po aty 240) një numër i madh personash. Në listën e këtyre personave, në një nënndarje të titulluar nga autori si *Romët (Kiptyan)*, ¹⁵ gjejmë edhe 21 persona (po aty, 253-254) ndër të cilët 7 janë „orkestrantë“ ¹⁶ (Mehterler-ë). Këta janë: Hasan Hysejn-i, Balli Jusuf-i, Inehan Mustafa-i, Xhafer Hasan-i, Jusuf Memi-u, Sinan Jusuf-i, Jusuf Ahmed-i (po aty, 254).

Profesioni tjetër që kanë *Kyptian*-ët e tjerë, që përmban kjo listë, është ai i farkëtarit.

Nëse përmbledhim informacionet që përmban kjo shkresë, mësojmë se: *a)* Në Berat kishte një bashkësi *Kiptyan*-ësh që përbëhet prej 21 familjesh ¹⁷, *b)* Këta *Kiptyan*-ë merrnin pjesë nëpër luftërat e ndryshme që zhvilloheshin nëpër rrethina, jo vetëm në një, por në disa, domethënë, e kishin të zakonshme të shkonin, *c)* Për këto shërbime këta *Kiptyan*-ë shpërbleheshin, *d)* Zanatet e tyre ishin farkëtarit (kovaçi) dhe muzikanti.

Nëse analizojmë informacionin e mësipërm, nxjerrim se: për *a)* duket sikur bie në kundërshtim me informacionin që na jep Çelebiu pothuaj një shekull më vonë, kur thotë se në Berat „*nuk ka lagje jevgjish, ermenësh dhe frëngjsh*” (ÇELEBI, 2000-56). Këtë gjë e vëren edhe Duka, i cili mendon se Çelebiu e ka fjalën për “*ciganët (harixhinjtë)*” dhe jo për “*evgjitët*” ¹⁸.

Ndoshta Duka ka të drejtë, por mospërputhja e të dhënave duhet parë edhe nga dy këndvështrime të tjera. *Së pari*, shpesh informacionet e Çelebiut mbështeten në të dhëna prej burimeve dytësore (zyrtarët që e prisnin dhe e përcillnin), të cilët, për një arsye apo tjetrën, nuk i tregonin atij gjendjen e vërtetë ¹⁹. Ka të ngjarë që edhe ky rast të jetë i tillë. Nëse është kështu, informacionin e Çelebiut do të na duhet ta vështrojmë si të pasaktë ²⁰.

Së dyti, në përshkrimin e Dokumentit në fjalë muslimanët e Kalasë së Beratit janë renditur sipas profesioneve dhe jo sipas mëhallave. Ndërkaq, komunitetet e tjera (të krishterët dhe hebrenjtë) renditen sipas mëhallave. Pyetja e parë që del këtu, është: A formonin evgjitët e Beratit një “*mëhallë*” të tyre në periudhën mes vitit 1583, kur është shkruar ky dokument, dhe vitit 1670, kur Çelebiu vizitoi qytetin? Duka nuk na thotë që këta evgjitë kishin një mëhallë të tyre. Në dokumentin që ai boton, e gjithë bashkësia “*muslimane*” banon në Lagjen e Kalasë ²¹. Pra Duka thotë vetëm se këta “*evgjitë*” ishin muslimanë dhe pak më tej shton se: “... *deri në këtë moment, në qytetin e Beratit nuk ishin krijuar ende mëhallët e veçanta të muslimanëve, ...*” (po aty, fq. 177).

E vetmja gjë që mund të përfundojmë prej sa më sipër, është se në Berat nuk ka ekzistuar një “*mëhallë e evgjitëve*” as në kohën

kur është shkruar ky Defter dhe as në kohën kur Çelebiu vizitoi qytetin, dhe se këta “evgjitë” rronin në një “bashkësi muslimanësh”. Por ç’qenë këta “evgjitë muslimanë”? Këtu vijmë te përgjigja e pikës b) dhe edhe Duka na jep më poshtë një argument që e ndihmon këtë përgjigje, kur thotë se: “Emërtimi në fjalë (bashkësi muslimane e Kalasë - shën. ynë) ishte shprehje e funksioneve të popullsisë qytetare të islamizuar që lidheshin me mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e Kalasë dhe jo me vendbanimin e saj” (po aty, fq. 177). Ndërkaq, shprehja „popullsisë qytetare të islamizuar”, e cila nënkupton që kjo popullsi ishte vendase, nuk na duket e saktë. Përpara pushtimit otoman nuk dokumentohet që në këtë zonë të kenë banuar „bashkësi” rome apo evgjite.

Si përfundim, “evgjitët” e Defterit të vitit 1583 kishin ardhur së bashku me ushtrinë otomane (përderisa jetesa e tyre ishte kaq e lidhur me këtë të fundit), banonin në zonën e fortifikuar të qytetit (në Kala) dhe kryenin shërbime që ishin të lidhura me detyrat e administratës dhe garnizonit ushtarak otoman. Por ata merrnin pjesë në luftime. A do të thotë kjo se ata ishin ushtarë?

Rastet kur romët bënin pjesë në administratën ushtarake, veçanërisht në ushtrinë e jeniçerëve, janë të shumta. Qysh në kohën e Sulltan Murad-it I ata ishin edukatorë (stërvitës) të jeniçerëve të rinj dhe, madje, me ferman të Sulltanit ²² arrinin të bëheshin edhe komandantë. Këtyre *Kyptyan*-ëve u jepeshin edhe toka të krishtere pas fitores së luftërave (COZANNET, 1973-33). Por evgjitët tanë nuk janë të këtij lloji dhe shërbimet e tyre në ushtrinë osmane nuk ishin të atilla sa që të shpërbleheshin me prona. Të paktën Defteri nuk përmend një gjë të tillë. Ata shpërbleheshin me “*dhurata*” më të vogla (siç është edhe falja e taksave) dhe kjo i jep përgjigje edhe pikës c).

Pra, këta “evgjitë”, ashtu siç na thotë edhe Defteri i vitit 1583, nuk ishin veçse një “*prapavijë*” e domosdoshme e ushtrisë otomane që bënin ato punë të cilat tradicionalisht i bënin vetëm romët: mirëmbajtjet e ndryshme (kovaç) dhe zbavitjen (muzikant). Madje nuk ishin as ushtarë të mirëfilltë në kazermë, sepse duke qenë “*kryefamiljarë*” që paguanin rregullisht taksat, logjikisht ata banonin në familjet e tyre ²³.

Kaq na thotë ky Defter dhe, nëse nuk do të gjejmë edhe

dokumente të tjera që flasin për atë kohë, shumë pyetje do të mbeten pa një përgjigje të sigurt: Ç'loj mehterler-ë ishin këta evgjitë? Ç'muzikë luanin ata? Ç'instrumente përdornin? Si ishin të organizuar? etj.

Prej shpeshtësisë së mbiemrave (mbiemri Jusuf-i shfaqet dy herë) kuptojmë se zanati që ata ushtronin, (në rastin tonë muzika) ishte *"brenda familjes"* dhe, ndoshta, edhe i trashëguar nga brezi në brez, siç ishte edhe tradita.

Duke qenë se e vetmja gjë që mund të vërejmë me siguri përmes këtij dokumenti është se këta mehterler-ë qenë të lidhur me ushtrinë, shumë prej pyetjeve të mësipërme mund t'u përgjigjemi në mënyrë analogjike duke krahasuar të dhënat tona me ato të organizimit të përgjithshëm të jetës muzikore të Perandorisë. Megjithatë, as kjo metodë nuk na thotë dot ndonjë gjë mbi vendin që zinin në *"hierarkinë muzikore"* të qytetit „evgjitët” tanë, apo mbi mënyrën se si shfaqej kjo *"ierarki"* në një qytet të largët, ndonëse të rëndësishëm të Perandorisë ²⁴.

Pra, i vetmi përfundim i saktë që mund të nxjerrim këtu, është se një pjesë e jetës muzikore të Beratit, në fundin e shekullit XVI, (kishte filluar të?) formohej sipas modelit të vendosur në qendrën e Perandorisë, model që vazhdoi shumë gjatë i pandryshuar.

2. Shekulli XVII

Ndonëse edhe në këtë shekull burimet dokumentare apo analoge mbi jetën muzikore të qyteteve shqiptare janë përsëri fare të pakta, këtë radhë, sasia dhe cilësia e informacionit na lejon të krijojmë një ide shumë më të qartë mbi gjendjen se sa ajo e një shekulli më parë.

Shënimet e Evlija Çelebiut

Në shumë prej qyteteve shqiptare Çelebiu ka parë *„vende dëfrimi"* të shumta ²⁵ dhe shqiptarët i përshkruan si një popull që merren me dëfrime ²⁶. Por jo të gjitha vendet e dëfrimit kanë patjetër lidhje me muzikën, sepse mund të jenë edhe vende *„ku disa nga zotërinjtë bëjnë banja"*, ku *„zihet peshk"*, ku *„shkohet për gjah"* apo ku *„shumica bisedojnë e diskutojnë për probleme fetare,*

shkencore, politike", si p.sh., në Berat (ÇELEBI, 2000-60). Dhe jo të gjitha „dëfrimet” përcaktohen se ç’janë ²⁷.

Megjithatë, në disa prej këtyre vendeve, si p.sh., në Elbasan te Buza e Shkumbinit (që Çelebiu e quan Buzeshk) „... mbështillen dashnorët e dëfrehen me ahengje e me këngë, të kënduara nga ashikët, si bylbylat e pranverës; këtu ushtojnë këngët dashurore të përcjella me melodi gazmore apo melankolike, të cilat ndezin e përvëlojnë zemrat e dëgjuesve” (ÇELEBI, 2000, fq. 100, 101). „Këngët dashurore” Çelebiu i dëgjon edhe në Gjirokastër dhe na informon se: „Një zakon tjetër i gjirokastritëve është se ditën e Shën Gjergjit, të Nevruzit, ditën e Shën Mitrit, të Sari Sallteikut si dhe në të dy Bajramet, të veshur krejt me ar, pasi pinë mirë e mirë dhe e mbushin kokën me verë të kuqe, dashurues e dashurorë (ashikë e dylberë), kapen qafë për qafë dhe heqin e kërcejnë valle.” (po aty, fq. 38).

Një tjetër valle, por këtë radhë pas një dasme në Zharovinë, Çelebiu „e heq” edhe vetë: „... u nisëm me nusen, duke thënë që të gjithë Allah, All-ah, e duke hequr valle gjelash si mohues të zotit” (po aty, fq. 42).

Ndër „përvojat” e tjera muzikore të Çelebiut në Shqipëri bën pjesë edhe përshkrimi i mënyrës së vajtimit në Gjirokastër ²⁸ dhe edhe „mospërshkrimi” i një „dasma madhështore e të bujshme sipas zakonit shqiptar” në Libohovë (po aty, fq. 43), në të cilën ai mori pjesë ²⁹. Ky „mospërshkrim” është një humbje e madhe për etnomuzikologjinë shqiptare - një dëshmi e ceremonisë së dasmës që vjen prej më shumë se tre shekuj më parë do të na sillte të dhëna shumë të çmuara mbi atë si ishte dasma shqiptare në një periudhë kur ndikimet lindore dhe islamike ishin relativisht më të dobëta se sa sot.

Më në fund, shënimet e Çelebiut na zbulojnë se mes zyrtarëve të Beratit kishte edhe një „kryetar të bandës muzikore” (po aty, 50); se në disa qytete të Shqipërisë kishte edhe „vjershëtorë” (bejtexhinj) ³⁰ dhe se në shkollat dhe në xhamitë e qyteteve tona mësoheshin edhe „meloditë kuranore”. ³¹

Nëse i përmbledhim këto të dhëna, vërejmë se ato ndahen në dy grupe kryesore. Grupi i parë përfshin të dhënat mbi muzikën dhe vallen vendase (vajtimet e „vajtoicave të pajtuara” në Gjirokastër, vallja që heqin burrat e këtij qyteti dhe vallja „gjelash” që „heq” edhe vetë Çelebiu pas kthimit nga dasma në

Zharovinë). Ndër këto të tria, dy të parat janë qartësisht „qytetare“. E treta, „vallja gjelash“, është edhe ajo qytetare, nëse mendon se kortezhi i nuses përbëhej nga njerëz „të sërës“ dhe të qytetit, ndonëse dasma bëhej në shtëpinë e ndonjë beu nga fshati i Zharovinës. Megjithatë, duke u nisur prej faktit që a) kjo valle nuk ekziston më në këtë krahinë, b) që dasmorët ishin njerëz të parisë së administratës osmane, dhe c) që prania e Çelebiut mund të ketë shtyrë që të vallëzohet për nder të tij edhe ndonjë prej atyre valleve në modë që luheshin edhe në kryeqytetin e Perandorisë, mund të mendohet se ndoshta edhe kjo valle ishte ndonjë prej tyre.

Për sa i përket vajtimeve, duhet vënë re se, kur flet për to, Çelebiu flet vetëm në shumës. Kjo gjë na shtyn të mendojmë se e ka fjalën për atë lloj të veçantë të të vajtuarit kolektiv që quhet „e qarë me bote“ e që rron akoma, të paktën në kujtesën e banorëve të këtij qyteti. Ndërkaq, përshkrimi i valles së burrave përkon me veçori të valles labe në krahinat përreth qytetit. Nuk e dimë se kush e ka vallëzuar këtë valle, por, duke parë se në qytet ndoshta kishte rënë murtaja, shtyhem të mendojmë se këta valltarë duhet të kenë qenë njerëz të afërt apo njerëz të besuar të shpurës së parisë fetare, të administratës ushtarake apo asaj ekonomike të vendit, tek e cila bujti edhe udhëtari ynë³².

Grupi i dytë i të dhënave përfshin të dhëna që lidhen me muzikën qytetare apo muzikën zyrtare standarde për të gjithë perandorinë. Kryetari i „bandës muzikore“ apo Mehterbashi, duhet të jetë drejtuesi i njërës prej atyre Mehterhaneve të shumta që kishin Disdarët nëpër kështjellat e ndryshme të Perandorisë,³³ mbeturina të të cilave janë sot formacionet e frymës të ciganëve në Ballkan. Këngët „dashurore“, të kënduara prej „ashikëve“ të Elbasanit, kujtimi i të cilave rron akoma sot edhe në qytete të tjera të Shqipërisë (Kavajë), nuk janë gjë tjetër përveçse ata „Bejtexhinj popullorë“, d.m.th., „Këngëtorë popullorë“ (...) të cilët më shpesh përcillnin këngë dashurie“, që kishin „përgjithësisht një profesion „qytetar“, të cilët, qysh në fillimet e tyre, ishin „pjesërisht laikë e pjesërisht fetarë“ (REINHARD, 1975, 1-2) dhe që u shpërndanë në fillim si këngëtorë endacakë e më pas zunë vend në të gjitha cepat e Perandorisë dhe e përcollën këngën e tyre edhe te vendasit.

Sa për „ashikët e dylberët” e Gjirokastrës dhe vallen e tyre, mendojmë se ky informacion duhet marrë me rezervë. Sot në këtë qytet nuk kemi asnjë gjurmë të valleve të këtij lloji, as ndonjë kujtim që ato të kenë ekzistuar dhe as ndonjë zakon të tillë të mbetur në kujtesë. Ka të ngjarë që Çelebiu, i cili nuk ishte edhe aq i pavëmendshëm ndaj djemve të rinj,³⁴ ta ketë kuptuar edhe gjestikën e valleve labe, ku burrat „kapen qafë për qafë dhe heqin e kërcejnë valle” si gjestikë erotike.

Siç është e natyrshme, edhe në qytetet e Shqipërisë, ashtu si dhe në të gjithë Perandorinë të „mësoheshin” „meloditë kuranore” dhe, ndonëse Çelebiu e vëren këtë gjë vetëm në Berat, prania e shkollave fetare dhe e xhamive edhe në qytetet e tjera të vendit tonë na shtyn të besojmë se ky „mësim” ka qenë qysh në atë kohë një praktikë e zakonshme.

Ndërkaq vërejtja e Çelebiut mbi ekzistencën e „vjershëtorëve” (bejtexhinjve) është shumë interesante. *Së pari*, sepse, me sa njohim deri tani, letërsia e bejtexhinjve shqiptarë në gjuhën shqipe fillon vetëm në shekullin XVIII me bejten *Lutje për kafënë* të Muçi Zades (1725), të zbuluar në Korçë (ELSI, 1997-73 dhe 74). Bejtexhinj shqiptarë që shkruanin në arabisht e që banonin në Turqi, njihen qysh në shekullin XV³⁵ dhe njihen edhe prozatorë të tillë³⁶. *Së dyti*, sepse, siç dihet, disa prej gjinive që shkruanin bejtexhinjtë, këndoheshin e shoqëroheshin edhe me instrumente muzikore dhe kjo tregon se, në periudhën për të cilën flasim, ekzistonte edhe një lloj tjetër më i „kultivuar” i muzikës qytetare. Dhe jo në një qytet të vetëm, sepse Çelebiu i ka parë në Berat, (po aty 60) dhe në Gjirokastrë i ka njohur edhe me emër Buqajiu-n, Figaniu-n, Naleshi-n, Sukuniu-n e Firagiun që „janë shumë të zotë. Sidomos Naleshi nuk ka shok” (po aty, 38)!

Dokumentet historike

Zija Shkodra, në librin e tij *Esnafet shqiptare (shek. XV – XX)*, na njofton për një dokument të vitit 1606 që (duhet të) gjendet në Arkivin Qendror të Shtetit (AQSh)³⁷ dhe që bën fjalë për tajfet e muzikantëve në qytetin e Elbasanit (SHKODRA, 1973-207).

Fatkeqësisht, ne nuk kemi arritur ta identifikojmë këtë

dokument dhe këtu jemi të detyruar të citojmë vetëm shënimin e Shkodrës: *“Si forma primitive esnafore të vogla vlejné të përmenden edhe tajfat e muzikantëve. Këto grupe prej 5-10 instrumentistësh të dalluar që na kujtojnë “meistersingerët” gjermanë, apo “menestrelët” shëtitës italianë i gjejmë në disa krahina të vendit tonë qysh në shek. XVI – XVII. Një tajfë e tillë prej gjashtë vetash ishte edhe ajo e qytetit të Elbasanit e vitit 1606. Për të kënaqur popullin dhe ushtrinë e këtij qyteti në lulëzim, këta u binin dy herë në ditë daulleve dhe zurnave (...). Prandaj ishin përjashtuar edhe nga taksat dhe detyrimet e zakonshme të kohës.”*

Informacioni i mësipërm është pak i turbullt. Siç duket autori ka dashur të përgjithësojë ekzistencën e tajfeve të muzikantëve në një periudhë historike më të gjerë dhe i ka përzierë pa e ditur llojet e tyre sepse sapo që përmend se këto tajfe ishin „shëtitëse” thotë se tajfe e Elbasanit i binte „dy herë në ditë daulleve dhe zurnave”. Tajfet shëtitëse (që në një dokument pak më të vonë quhen *Calici mehterleri*), ishin ose ato që sot i quajmë “saze” dhe përdornin instrumente, si: „*violinën* (Kemenceh - shën. ynë), *fyellin, sazen, kanunin dhe jongarin*” (po aty), ose formacionet e vogla të ciganëve me daulle dhe zurna. Ishin pikërisht këto tajfe që: „*qoftë edhe nëpër katunde, jepnin edhe koncerte nëpër dasma dhe synetllëke*” (po aty).

Ndërsa në rastin e tajfes së Elbasanit që u binte dy „herë në ditë daulleve dhe zurnave” kemi të bëjmë me një Nevbet (*Nevbet* pers. - *Radhë, radhë periodike, Roje, Roje nate*), pra me një muzikë ushtarake dhe një mehterhan ushtarak³⁸. Këtu vërtetojmë edhe saktësinë e informacionit që na jep Çelebiu afërsisht 64 vjet më vonë, kur shkruan se në Berat ka edhe një „*dirigjent bande*”. Pra, këtu vërtetojmë përfundimisht se kjo „*bandë*” ka qenë mehterhan-i i jeniçerëve dhe se ky mehterhan ka ekzistuar të paktën që në fillim të shekullit XVII. Por a kishte aso kohe në Berat një Nevbethane (një vend të caktuar ku luante kjo mehterhane apo ndonjë ngrehinë e saj)? Këtë mbetet ta gjurmojnë historianët dhe arkeologët. Dokumentet nuk na thonë gjë.

Më pas citati i Shkodrës vazhdon edhe më tej të përziejë (të përgjithësojë) kohërat dhe llojet e muzikantëve. Ne nuk do të ndalemi më në analizën e kësaj përzierjeje që përfshin një kohë

edhe më tej se sa shekulli XVII, sepse nuk është qëllimi i këtij punimi. Megjithatë, do të përmendim akoma se në këtë citat flitet edhe për një tjetër dokument (të vitit 1718) që gjendet në AQSh prej të cilit mësojmë se: „*tajfat e muzikantëve të vendit tonë, sikurse ato të krahinave të tjera të ejaletit të Rumelisë, u paguanin kryemuzikantëve të ejaletit një taksë vjetore*” (SHKODRA, 1973-207).

Dokumenti tjetër i shekullit XVII, që flet për muzikantët, është një urdhëresë që u drejtohet kadijve të Rumelisë e hartuar në vitin 1681, pra pak më shumë se dhjetë vjet pas udhëtimit të Çelebiut ³⁹. Në të porositen kadijtë e Rumelisë që të mbledhin taksat prej muzikantëve (*Calici Mehterleri*) të kazave për të mbajtur muzikantët e Bejlerbeut (*Satirlar Mehterleri*). Mbledhja e taksave bëhet prej një përfaqësuesi të Kryemuzikantit (*Mehterbas*).

Këtu më poshtë po japim përkthimin e këtij dokumenti:
AQSh / Zyra e Sherries së Beratit, Dosja 49, fleta 123 in recto
Kadijtë e Rumelisë, atyre i u shtoftë lavdia!, njoftohen se:
Sipas urdhëresës që është përpiluar, tajfa e orkestrantëve (calici mehterler) që ndodhen në kazatë tuaja, ashtu sikundër gjer më tani, duhet të japin detyrimin për orkestrantët (satirlari mehterler) të bejlerbeut (Mirmiranit). Kur të mbrijë atje përfaqësuesi i Kryemuzikantit (Mehterbashit) (emri nuk shënohet - shën. përkth.) është e domosdoshme që, sikundër ju është bërë e qartë, të mblidhni taksën në fjalë nga orkestrantët (calici mehterler) e kazave tuaja për orkestrantët (Mirmiran mehterleri) dhe pjestarët e grupit të shoqërimit (satirlari) të bejlerbeut (Mirmiranit). Atë duhet t'i a dorëzoni përfaqësuesit të kryemuzikantit (Mehterbashit). Mos i jepni askujt pretekst për kundërshtime.

14 Safer 1092 (15 mars 1681)

(Përkthyer nga Prof.Dr. Ferit Duka)

Termin *Calici Mehterleri* e gjejmë edhe te Çelebiu (ÇELEBI, 1896, Vol.I-621). Ai do të thotë „muzikantët që luajnë, godasin” dhe Konyali e lidh atë me Tablhane-n ⁴⁰, ndonëse nuk është akoma shumë e qartë nëse ky term ishte një term popullor apo shënonte muzikantët e Oborrit.

Prej dokumentit tonë del se *Calici Mehterleri* ishin një shtresë mehterler-ësh që paguanin taksa dhe taksat e tyre përdoreshin

për të mbajtur mehterler-ët e Bejlerbeut. Nga ana tjetër, *Calici Mehterleri* nuk rronin pranë Mirmiranit, por në „kazarë“ e tjera. Pra, ata ishin muzikantë të një shtrese më të „ulët“, ndoshta pikërisht ata muzikantë endacakë për të cilët flet Shkodra e që shkonin nëpër festa të ndryshme familjare apo lokale dhe siguronin bukën e gojës me fitimet që nxirrnin prej tyre.

Nga ana tjetër, *Satirlar Mehterleri* (herën e dytë shkruhet: *Mirmiran Mehterleri*) ishin shtresa „e lartë“ e Mehterler-ëve, e cila banonte pranë Bejlerbeut (*Mirmiranit* - prandaj edhe quhej kështu) dhe paguhej ⁴¹ për të kryer shërbimet e nevojshme të oborrit të tij. Pra, këta Mehterler-ë ishin nëpunës apo të punësuar të lartë të Oborrit (në rastin tonë të Bejlerbeut) të cilët qëndronin pranë (e shoqëronin) tij edhe në jetën civile (në ceremonitë e ndryshme) edhe nëpër luftëra.

Mehterbashi (Kryemuzikanti) ishte eprori i tyre. A ishte ai i njëjti Kryetar i „bandës muzikore“ që na përshkruan Çelebiu dhjetë vjet më parë? Ndoshta po, por ajo që është këtu e rëndësishme dhe që mungon në përshkrimin e Çelebiut, qëndron në faktin se jeta muzikore e Beratit në këtë periudhë është strukturuar qartësisht sipas modelit Perandorak. E gjithë superstruktura përbëhet prej një elite ⁴² të vlerësuar dhe të paguar mirë që bënte pjesë në shtresën më të lartë të administratës, dhe që kryente vetëm detyra „të zgjedhura“ ⁴³. Në anën tjetër kemi edhe një shtresë tjetër muzikantësh civilë që e nxirrnin bukën e gojës nëpër festa popullore apo familjare dhe që paguanin taksa.

Përsëri nuk e dimë se ç’instrumente përdornin këto lloje muzikantësh. As shënimet e Çelebiut nuk na thonë gjë për to. Ndaj edhe këtu na duhet të mjaftohemi me përfundimin se, nëse një pjesë e jetës muzikore e qytetit shqiptar të shekullit XVII ishte organizuar sipas modelit perandorak osman, edhe pjesa tjetër duhej të përkonte me të. Pra, *Mehterhan-i* i oborrit apo i kështjellës luante në ato instrumente që luanin mehterhan-ët sivëllezër në të gjithë perandorinë. *Calici Mehterleri*, edhe ata ndiqnin të njëjtat modele.

Por, nëse për të parët gjendja është e qartë, sepse standardi (Qanuun) ishte i paprekshëm, ⁴⁴ të dytët përballeshin vazhdimisht me një botë që trashëgonte dhe përpiquej të ruante me kokëfortësi zakone, kultura dhe identitete të ndryshme. Ndaj

pyetjet që ngrihen këtu, janë: Sa reflektonin këta *Calici Mehterleri* prej këtyre zakoneve, kulturave dhe identiteteve të ndryshme? Sa përshtateshin ata me to? A kishte filluar të ndihej qysh në atë kohë ndikimi lokal në muzikën qytetare të Perandorisë?

Mbyllje

Pas vrojtimeve të mësipërme, mund të përfundojmë se:

1. Intensiteti i ndikimit të muzikave të lindjes mbi muzikën e vendeve të Rajonit të tyre vjen duke u rritur duke filluar me shekullin XIII, ndonëse nuk duhet lënë pas dore edhe periudha paraardhëse me lëvizjet e saj të mëdha të popullsive (arabët, Bizanti) etj.

2. Duke filluar me shek. XVI, një pjesë e jetës muzikore të qyteteve shqiptare organizohet sipas modeleve standarde të të gjithë Perandorisë osmane, deri sa në shekullin XVII këto modele bëhen mbizotëruese.

3. Krahas dukurive dhe më pas edhe modeleve lindore, në Shqipëri ekzistonte edhe një shtresë tjetër e muzikës qytetare.

Literatura e shfrytëzuar:

ANTONI, Lorenc 1974 - *Veçoritë bazë të muzikës shqiptare të Kosovës dhe Metohisë*, Rad XIV SUFJ, Prizren 1967, Beograd

BANFI, Emanuele

1985 - *Linguistica Balcanica*, Bologna

COZANNET, F. 1973 - *Mythes et coutumes religieuses des tsiganes*, Payot, Paris,

ÇABEJ, Eqrem 1975 - *Për një shtresim kronologjik të huazimeve turke në gjuhën shqipe*, Studime Filologjike, nr. 4,

1976 - *Vepra*, vol. III, Rilindja, Prishtinë

ÇELEBI, Evlija, Muhammed ibn Derwish 1896 - *Siahatnaameh*, Vol. I., Aqdam Matbaasi, Kontantiniyye, 1314 2000 - *Shqipëria para tre shekujsh*, Besa, Tiranë

DEMIRAJ, Shaban 1994 - *Gjuhësi ballkanike*, Logos A, Shkup

DEVIC, Dragoslav 1983 - *Orientaliska ili balkanska gama u narodnie pesmi Srbije i Makedonije*, Makedonski Folklor, nr. 32

DISDARI, Tahir 2005 - *Fjalor i Orientalizmave në Gjuhën Shqipe*,